



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 57, datë 31.05.2022

**PËR**  
**DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR DËME SI**  
**PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESAT E TYRE**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, VKM-së nr. 329, datë 16. 05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afat mesëm 2022-2024”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike si dhe Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare prej 18 818 076 (tetëmbëdhjetë milion e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre, sipas listës bashkëlidhur.
2. Fondi për dhënien e ndihmës financiare do të mbulohet si më poshtë :
  - Vlera prej 11 700 660 (njëmbëdhjetë milion e shtatëqind mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë do të mbulohet nga transfertat sektoriale për mbrojtjen civile e trashëguar nga viti 2021.





- Diferenca prej 7 117 416 (shtatë milion njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë do të mbulohet nga fondi i emergjencave civile i miratuar me VKB-në nr.158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afat mesëm 2022-2024”.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

### KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi

**U shpall sot me datë 01.06.2022**




TABELA PËRMBLEDHËSE PËR BANORËT E DËMTUAR QË PËRFITOJNË NGA FONDI I EMERGJENCAVE CIVILE



Nr	Emër Mbiemër	Vlera përfituese
1	Hamza Rudi	158,000
2	Drilon Hajdaraj	265,000
3	Dajlan Kozeli	158,254.50
4	Fisnik Mazrreku	700,000
5	Mislum Koldashi	1,127,000.00
6	Naim Arifi	160,394
7	Emine Çakërri	25,689.50
8	Gentjana Lusha	358,000
9	Nushe Lushaj	505,000
10	Alban Dermyshe	420,000
11	Florenc Peqini	395,000
12	Gazmir Xhakolli	1,127,353
13	Bledar Brahimaj	1,466,294.90
14	Haki Kercyku	343,500
15	Shefqet Alla	1,010,581.50
16	Isuf Osmani	1,038,981.50
17	Nafije Myzyri	428,325
18	Llukman Shehu	887,500
19	Rifat Bicaku	1,053,000
20	Adriatik Muca	911,284
21	Fiqiri Demiraku	351,500
22	Resmije Palushi	583,660.80
23	Brahim Bardhoci	720,000
24	Eltion Nexhipi	786,773
25	Naim Alhysa	978,000
26	Marsilda Halilaj dhe Benar Halilaj	451,000





27	Luljeta Kollçaku	1,019,194
28	Sanije Kryeziu	522,765
29	Mentor Losha	866,026.00
<b>Total vlera</b>		<b>18,818,076</b>





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 474 / prot.

Durrës, më 07.06.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.57 datë 31.05.2022 “Për dhënien e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
EMILJAN JANI

